



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.184

dhjetor

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.1012, datë 10.12.2010	Për miratimin e rregullores “Për sinjalistikën në kantier dhe në vendin e punës”..... 10247
Vendim i KM nr.1032, datë 16.12.2010	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të ndërtesave të ish-ndërmarrjes gjeologjike, Korçë, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te Ministria e Financave, dhe të zyrave të agjencisë së sigurimeve shoqërore, Korçë, nga Ministria e Financave te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës..... 10261
Vendim i KM nr.1079, datë 10.12.2010	Për kalimin e objektit “Ish-kombinati i tekstileve”, Berat, me numër pasurie 19/95, në zonën kadastrale 8501, me sipërfaqe 8117 m ² , në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, si dhe për një ndryshim në vendimin nr.226, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor”..... 10264
Vendim i KM nr.1080, datë 22.12.2010	Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njërive vullnetare të shuarjes së zjarreve..... 10264
Udhëzim i METE nr.915, datë 27.12.2010	Për procedurat e zgjedhjes së organeve të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë..... 10267
Vendim i KKRT nr.202, datë 20.12.2010	Për dhënie licence për radion vendore private “Radio Durrësi” subjektit “Radio Durrësi” sh.p.k..... 10269

Vendim i KKRT nr.203, datë 20.12.2010	Për zgjerim zone licencimi për radion vendore private “Radio Eagle” subjektit “Dynamics Sound” sh.p.k.....	10270
Vendim i KKRT nr.204, datë 20.12.2010	Për zgjerim zone licencimi për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Star” subjektit “Star Tv” sh.p.k.....	10270
Vendim i KKRT nr.205, datë 20.12.2010	Për mosdhënie licence për radion vendore private “Radio Kruja” subjektit privat fizik Lulëzim Spata.....	10271
Vendim i KKRT nr.206, datë 20.12.2010	Për mosdhënie licence personit fizik z.Bilbil Hajdini për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Alfa Hajdini”	10271
Vendim i KKRT nr.207, datë 20.12.2010	Për mosdhënie licence personit fizik zj.Ëngjëllushe Veliaj për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Orexh”	10272
Vendim i KKRT nr.208, datë 20.12.2010	Për mosdhënie licence personit fizik z.Arben Asllani për televizionin privat kabllor “Tv kabllor 2 ASL”	10272
Vendim i KKRT nr.209, datë 20.12.2010	Për mosdhënie licence personit fizik z.Vullnet Nazëraj, për televizionin privat kabllor “Tv kabllor ARD&NET” ..	10273
Vendim i KKRT nr.210, datë 20.12.2010	Për mosdhënie licence personit fizik z.Artan Zhupani, për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Fier-Seman” ..	10273
Vendim i KKRT nr.218, datë 20.12.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Koha”	10274
Vendim i KKRT nr.219, datë 20.12.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Vlora Channel”	10274
Vendim i KKRT nr.220, datë 20.12.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Eagle”	10275
Vendim i KKRT nr.221, datë 20.12.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Emanuel”	10275
Vendim i KKRT nr.222, datë 20.12.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Devi E.R.I.”	10276
Vendim i KKRT nr.223, datë 20.12.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Muzika Jonë”	10276
Vendim i KKRT nr.224, datë 20.12.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Channel 1”	10277
Vendim i KKRT nr.237, datë 20.12.2010	Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Radio Take 5” sh.p.k., për vlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Take 5”	10277

VENDIM
Nr.1012, datë 10.12.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR SINJALISTIKËN NË KANTIER DHE NË VENDIN E PUNËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, të pikës 3 të nenit 42 të ligjit nr.10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe të pikës 3 të nenit 40 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për sinjalistikën në kantier dhe në vendin e punës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR SINJALISTIKËN NË KANTIER DHE NË VENDIN E PUNËS

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton dhe përshkruan rregullat minimale të sinjalistikës në kantier, për mbrojtjen dhe sigurinë e shëndetit gjatë kryerjes së veprimtarisë publike apo private.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet në çdo kantier e vend pune nga subjektet publike dhe private, që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet në sinjalistikën e përdorur për rregullimin e trafikut rrugor, hekurudhor, lumor, detar dhe ajror.
3. Kjo rregullore nuk do të zbatohet për shenja, për vendosjen në treg të substancave dhe preparateve të rrezikshme, produkteve dhe/ose pajisjeve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në aktet e tjera ligjore.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Sinjalistika për sigurinë dhe/ose shëndetin në kantier dhe vend pune”, sinjale që i referohen një objekti specifik, veprimtarie ose situatë dhe që siguron informacion ose udhëzime rreth sigurisë dhe/ose shëndetit në punë me anë të një table, ngjyre, sinjali ndriçues apo sinjali akustik, një komunikimi gojor ose sinjali me gjeste (veprim), sipas rastit.

- b) “Sinjal ndalimi”, sinjali që ndalon sjelljen, që mund të shkaktojë një rrezik.
- c) “Sinjal paralajmërues”, sinjali që lajmëron një rrezik ose risk.
- ç) “Sinjal i detyrueshëm”, sinjali që përshkruan një sjellje të përcaktuar.
- d) “Sinjal i daljes së emergjencës ose i ndihmës së parë”, sinjali që jep informacion mbi daljet e emergjencës, të ndihmës së parë ose të mjeteve të shpëtimit.
- dh) “Sinjale të informimit”, sinjalet që japin tregues të ndryshëm nga ata të treguar nga shkronjat “b” të “d”.
- e) “Tabelë”, një sinjal që siguron informacion specifik nga një kombinim i një forme gjeometrike, ngjyrave dhe të një simboli ose vizatimi grafik, shikueshmëria e të cilit garantohej nga ndriçimi me intensitet të mjaftueshëm.
- ë) “Tabela suplementare”, tabela e vendosur (punuar) së bashku me një tabelë, të tipit tregues, sipas shkronjës “e” që jep një tregues suplementar ndihmës.
- f) “Ngjyrat e sigurisë”, ngjyra nëpërmjet të cilave jepet kuptimi i caktuar.
- g) “Simbol i vizatuar grafikisht”, pamje-imazh që paraqet një situatë ose që përshkruan një sjellje të përcaktuar e vendosur mbi një tabelë ose në një sipërfaqe të ndriçuar.
- gj) “Sinjal ndriçues”, sinjali prodhuar nga një aparat (dispozitiv) i përbërë nga material transparent ose gjysmë i tejdukshëm, i cili është i ndriçuar nga brenda ose nga pas në mënyrë të tillë që të sigurohet sinjal ndriçues.
- h) “Sinjal akustik”, sinjali zanor i koduar, i cili lëshohet dhe përcillet nga një aparat i projektuar për këtë qëllim, pa përdorimin e një zëri njerëzor apo artificial.
- i) “Komunikim gojor”, mesazhi gojor i paravendosur me përdorimin e zërit njerëzor ose të sintesave vokale.
- j) “Sinjal me veprime (gjeste)”, lëvizja apo pozicionim i krahut ose dorës në formë konvencionale për të drejtuar personin, që efektivisht kryen një punë, për të mos krijuar a shkakuar rrezik për punëmarrësit.

Neni 4

Detyrimet e punëdhënësit

1. Punëdhënësi duhet të parashikojë ose të verifikojë ekzistencën e një sinjalistike të sigurisë e të shëndetit në kantier dhe në vendin e punës, në përputhje me këtë rregullore, kur rreziku ose risku nuk mund të shmanget a të kufizohet në mënyrë të mjaftueshme me mjete teknike të mbrojtjes kolektive apo me masa, metoda dhe sisteme të organizimit të punës. Punëdhënësi merr në konsideratë çdo vlerësim të riskut, në përputhje me rregulloren e sigurisë në kantier, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.312, datë 5.5.2010 dhe ligjin nr.10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me qëllim shmangien e rrezikut, duke kryer:

- a) njoftimin e një risku ose të një rreziku të personit të ekspozuar;
- b) ndalimin e sjelljes që mund të shkaktojë rrezik;
- c) përshkrimin e caktuar të sjelljeve të nevojshme me qëllim sigurinë;
- ç) dhënien e treguesve relativë të daljeve të sigurisë ose mjeteve të shpëtimit e të sigurisë;
- d) dhënien e treguesve të tjerë në drejtim të parandalimit dhe sigurisë.

2. Nëse është e nevojshme, mund të jepen, nëpërmjet sinjalistikës së sigurisë, tregues relativë ose situata e riskut që nuk janë dhënë në aneksin I, sipas veçantisë së punës ose përvojës tekniko-profesionale.

3. Punëdhënësi, për të rregulluar trafikun e brendshëm të kantierit, ndërmarrjes ose njësisë prodhuese, i referohet, sipas rastit, sinjalistikës së parashikuar sipas legjislacionit në fuqi për trafikun rrugor, hekurudhor, lumor, detar ose ajror (sipas përshkrimit në aneksin V).

Neni 5

Informimi dhe formimi

1. Punëdhënësi parashikon, gjithashtu:

- a) Punëmarrësit dhe/ose përfaqësuesi i punëmarrësve për sigurinë duhet të jenë të informuar

për të gjitha masat e përshtatshme ose që duhen përshtatur për sinjalistikën e sigurisë e përdorshme në kantier ose në njësinë prodhuese;

b) Punëmarrësit të jenë të informuar për përshtatjen e të gjitha masave për sinjalistikën e sigurisë, e përdorshme në brendësi të kantierit ose në njësitë prodhuese.

2. Punëdhënësi parashikon që, për sigurinë, përfaqësuesi i punëmarrësve dhe punëmarrësit të marrin një informacion të përshtatshëm, në veçanti në formën e instruksionit të saktë që duhet të kenë për objektin e sinjalistikës së sigurisë, në mënyrë specifike dhe domethënëse, për të gjitha, dhe kjo përfshin përdorimin e veprimeve (gjesteve), fjalëve, si edhe sjelljet e përgjithshme e të veçanta që duhen ndjekur.

Neni 6

Këshillimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve

Këshillimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre kryhet në përputhje me pikat 8, 12 dhe 13 të aneksit V të rregullores “Për sigurinë në kantier” (miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.312, datë 5.5.2010), si dhe nenin 13 të ligjit nr.10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Neni 7

Përshtatja e anekseve

Përshtatja e karakterit teknik të anekseve nga I deri IX është në funksion të:

a) Adoptimit të rregullores në fushën e harmonizimit teknik dhe normativ, për sa i takon projektimit dhe prodhimit të mjeteve dhe pajisjeve të sinjalistikës së sigurisë e të shëndetit në vendin e punës;

b) Progresit teknik, zhvillimit të normativave të specifikimeve ndërkombëtare ose të njohjes në fushën e sinjalistikës për sigurinë dhe shëndetit në vendin e punës apo kantier.

Neni 8

Kërkesat për sinjalistikën

1. Sinjalistika e sigurisë e përdorur për herë të parë, duhet të bëhet në përputhje me përshkrimet e sjella dhe të përcaktuara në aneksin I të kësaj rregulloreje.

2. Sinjalistika e sigurisë e përdorur para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje duhet të përputhet dhe të zëvendësohet me përshkrimet dhe përcaktimet e aneksit nga I-IX të kësaj rregulloreje, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e saj.

ANEKSI I

PËRSHKRIME TË PËRGJITHSHME PËR SINJALISTIKËN E SIGURISË

1. Konsiderata paraprake

1.1 Sinjalistika e sigurisë duhet të jetë konform kërkesave specifike që figurojnë në anekset nga I deri IX.

1.2 Ky aneks përcakton kërkesat për përdorime të ndryshme të sinjalistikës së sigurisë dhe parashtron norma të përgjithshme mbi ndërrueshmërinë dhe të qenit plotësues të këtyre sinjaleve.

1.3 Sinjalistika e sigurisë duhet të përdoret vetëm për të transmetuar mesazhe ose informacione sipas përcaktimeve të nenit 2.

2. Mënyrat e sinjalizimit

2.1 Sinjalizim i përhershëm

2.1.1 Sinjalistika që i referohet një ndalimi, një paralajmërimi ose një detyrimi dhe, gjithashtu, ajo që shërben për të treguar vendndodhjen dhe për të identifikuar mjetet e shpëtimit ose të ndihmës së shpejtë, duhet të jetë e tipit e përhershme dhe e ndërtuar nga tabela sinjalistike të

destinuara për të treguar vendndodhjen dhe për të identifikuar materialet dhe pajisjet e mbrojtjes nga zjarri, që duhet të jenë të përhershme, e ndërtuar nga tabela ose nga një ngjyrë e sigurisë.

2.1.2 Sinjalistika e depozitave ose tubacioneve, e cila duhet të jetë e tipit sipas përcaktimeve në aneksin III.

2.1.3 Sinjalistika për rreziqet e goditjeve, kundër pengesave ose rënies së personave nga lartësia, duhet të jetë e tipit e përhershme e ndërtuar me një ngjyrë të sigurisë ose nga një tabelë.

2.1.4 Sinjalistika e rrugëve të qarkullimit duhet të jetë e tipit e përhershme, e ndërtuar me ngjyra të sigurisë.

2.2 Sinjalistika e rastësishme

2.2.1 Sinjalistika e rreziqeve, thirrja e personave për një veprim specifik ose për largim të menjëhershëm të personave, e cila duhet të bëhet në mënyrë të rastësishme dhe duke pasur parasysh principet e ndërrueshmërisë dhe të përputhshmërisë të parashikuar në paragrafin 3, nëpërmjet sinjaleve ndriçuese, zanore dhe të komunikimit me shkrim.

2.2.2 Drejtimi i personave që kryejnë veprime, që përmban një rrezik ose risk, duhet të bëhet sipas rastit nëpërmjet sinjaleve me veprime-gjeste ose komunikimit me shkrim.

3. Ndërrueshmëria dhe përputhshmëria e sinjalistikës

3.1 Nga efikasiteti dhe barazia e kushteve, që parashikon një veprim specifik për sa i përket informimit dhe formimit, është vendosur një zgjedhje e lirë ndërmjet:

- një ngjyre të sigurisë dhe një table, për të sinjalizuar një risk, një pengesë ose rënie nga disniveli;

- sinjale me lëvizje, gjeste ose komunikime me shkrim.

3.2 Disa modalitete të caktuara të sinjalistikës mund të përdoren së bashku në kombinimet specifike si vijon:

- sinjale ndriçuese dhe sinjale zanore;

- sinjale ndriçuese dhe komunikim me gojë;

- sinjale me veprime-gjeste dhe komunikim me gojë.

4. Ngjyrat për sigurinë

Treguesit e tabelës në vijim aplikohen-zbatohen në të gjitha sinjalet, për të cilat është parashikuar përdorimi i një ngjyre për sigurinë.

Ngjyra	Qëllimi dhe domethënia	Tregues dhe saktësime
E kuqe	Sinjal ndalimi Rrezik – alarm Material dhe pajisje kundër zjarrit	Qëndrim i rrezikshëm, Ndal, qëndro, dispozitiv të ndërprerjes të urgjencës Identifikimi dhe vendndodhja
E verdhë	Sinjal paralajmërues	Kujdes, vëmendje
E kaltër	Sinjal përshkrues	Sjellje ose veprim specifik, detyrim për PMI
Jeshile	Sinjal për shpëtim ose urgjencë	Porta, dalje korridore, vende ose mjedise, lokale

5. Efikasiteti i sinjalistikës nuk duhet të komprometohet nga:

5.1 Prezenca e një sinjalistike tjetër ose nga një burim i të njëjtit tip që turbullon shikueshmërinë ose dëgjueshmërinë, pra sjell në veçanti nevojën e:

5.1.1 evitimit të vendosjes së një numri të tepërt tabelash afër njëra-tjetrës;

5.1.2 mospërdorimit të njëkohshëm të dy sinjaleve ndriçuese që mund të ngatërrohen;

5.1.3 mospërdorimit të sinjaleve ndriçuese në afërsi të një burimi tjetër ndriçues pak i veçuar;

5.1.4 mospërdorimit njëkohësisht të dy sinjaleve zanore;

5.1.5 mospërdorimit të një sinjali zanor nëse intensiteti zhurmës vjen duke u shtuar.

5.2 Projektim i keq, numër i pamjaftueshëm, vendosje joracionale, gjendje e keqe ose funksionim i keq i mjeteve dhe pajisjeve të sinjalistikës.

6. Mjetet dhe pajisjet e sinjalistikës duhet, që sipas rasteve, të pastrohen rregullisht, t'u nënshtrohen mirëmbajtjes, kontrollit dhe riparimit dhe nëse është e nevojshme zëvendësimit derisa të arrihen parametrat kryesorë të funksionimit.

7. Numri dhe vendndodhja e mjeteve ose pajisjeve të sinjalistikës për t'u vendosur është në funksion të rëndësisë së riskut, të rreziqeve dhe të përmasave të zonës së mbulimit.

8. Për sinjalet, të cilat funksionojnë duke kërkuar burim energjie, duhet të sigurohet një burim emergjence në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike, me përjashtim të rasteve kur risku vjen më pak për shkak të ndërprerje së vetë energjisë.

9. Një sinjal ndriçues ose zanor me hyrjen në funksion, fillon nga një veprim që kërkon të realizohet; p.sh. duhet të ketë një kohëzgjatje të barabartë me atë të veprimit që do të kryet.

10. Sinjalistika ndriçuese dhe zanore duhet t'i nënshtrohen një verifikimi për mirëfunksionimin dhe efikasitetin real përpara se të vihen në përdorim, si dhe t'i nënshtrohen në vijim kontrollit periodik të nevojshëm.

11. Në rastin kur punëmarrësit paraqesin aftësi të kufizuar në shikim dhe dëgjim, eventualisht edhe për arsye të përdorimit të pajisjeve mbrojtëse personale, duhet bërë përshtatje e sinjalistikës në përputhje me masat suplementare ose zëvendësuese.

12. Zonat, sallat ose hapësirat që përdoren për magazinime të sasive të konsiderueshme të substancave ose preparateve të rrezikshme, duhet të jenë shënuar me një tabelë paralajmëruese në përputhje me pikën 3.2 të aneksit II ose në përputhje me pikën 1 të aneksit III, me përjashtim të rasteve kur etiketat e ambalazheve të ndryshme ose mbështjellëset janë të mjaftueshme për këtë qëllim.

ANEKSI II

PËRSHKRIME TË PËRGJITHSHME PËR TABELAT E SINJALISTIKËS

1. Karakteristikat thelbësore

1.1 Forma dhe ngjyra e tabelave përcaktohen në pikën 3 të këtij aneksi, në funksion të objektit të tyre specifik (tabelë ndalimi, përdorimi të mjeteve të mbrojtjes nga zjarri, paralajmërimi, përshkrimi dhe shpëtimi).

1.2 Vizatimet e tabelave duhet të jenë sa më të thjeshta me mosdhënie detajesh me kuptim të vështirë.

1.3 Vizatimet e përdorura mund të ndryshojnë lehtësisht nga ato të dhëna në pikën 3 ose të paraqesin në raport me to një numër më të madh veçantish, por domethënia të jetë ekuivalente dhe të mos krijojnë ekuivoke nga përshtatjet ose ndryshimet eventuale të bëra.

1.4 Tabelat duhet të bëhen me material sa më shumë të jetë e mundur rezistent ndaj goditjeve, ndaj veprimit të kohës së keqe dhe nga veprimet e faktorëve mjedisor.

1.5 Dimensionet dhe karakteristikat ngjyruese dhe fotometrike të tabelave duhet të jenë të tilla që të garantojnë një shikim të mirë dhe të kuptueshëm.

1.5.1 Për dimensionet rekomandohet të shikohet formula e mëposhtme: $A > L^2/2000$, ku A paraqet sipërfaqen e tabelës në m² dhe L është distancë e matur me metra nga ku tabela duhet të jetë akoma e shikueshme. Formula është e aplikueshme për një distancë deri në 50 metra.

1.5.2 Për karakteristikat ngjyruese dhe fotometrike të materialeve, referuar në standardin Shqiptar ose European.

2. Kushtet e përdorimit

2.1 Tabelat duhen vendosur duke pasur parasysh edhe pengesat eventuale, si: nga një lartësi ose pozicion në raport me këndin e shikimit, nga hyrja e zonës së interesuar në rastin e riskut të përgjithshëm, në afërsi të një risku specifik imediat ose të objektit, që ka për qëllim sinjalizimin, në një vend të ndriçuar mirë dhe lehtësisht i arritshëm dhe i shikueshëm.

Duke pasur parasysh rregulloren e kantierit në rastin e ndriçimit të keq natyral, është i pranueshëm përdorimi i ngjyrave fosforeshente, materialeve reflektues ose ndriçimi artificial.

2.2 Tabelat duhet të hiqen kur nuk qëndron më situata që e ka bërë të nevojshme vendosjen.

3. Tabelat që përdoren:

3.1 Tabela ndaluese

Karakteristikat thelbësore:

- Forma rrethore;
- Vizatim i zi, mbi sfond të bardhë;
- Buzët dhe shiriti (në drejtim poshtë majtas në të djathtë për gjatë simbolit të zi me një kënd 45°) i kuq, të cilat duhet të mbulojë të paktën 35% të sipërfaqes së tabelës.



Ndalohej duhani



Ndalohej duhani dhe
përdorimi i flakës



Ndalim kalimi



Ndalohej shuarja me ujë



Ujë jo i pijshëm



Ndalohej kalimi i personave
të paautorizuar



Ndalohej lëvizja e motopirunëve



Mos prek

3.2 Tabelë paralajmëruese

Karakteristikat thelbësore:

- Forma trekëndëshe;
- Vizatim i zi mbi sfond të verdhë;
- Buzët e zeza (e verdha duhet të mbulojë të paktën 50% të sipërfaqes së tabelës).



Material i djegshëm



Material eksploziv



Substanca helmuese



Substanca korrozive



Material radioaktiv
eksploziv



Ngarkesa të varura



Motopirun në lëvizje



Tension elektrik
i rrezikshëm



Kujdes rrezik



Rreze laser



Material i djegshëm



Rrezatim jojonizues



Fushë magnetike intensive



Rrezik pengesash



Rënie nga disnivele



Rrezik biologjik



Temperatura të ulëta



Substanca të dëmshme
dhe irrituese

3.3 Tabelë përshkruese

Karakteristikat thelbësore

- Forma rrethore;
- Vizatim i bardhë mbi sfond bojë qielli (ngjyra bojë qielli duhet të mbulojë të paktën 50% të sipërfaqes së tabelës).



Mbrojtje e detyruar e syve



Kaskë mbrojtëse e detyrueshme



Mbrojtje e detyruar e veshëve



Mbrojtje e detyruar e rrugëve
të frymëmarrjes



Këpucë sigurie të detyrueshme



Doreza mbrojtëse të detyrueshme



Mbrojtje e detyruar trupi



Mbrojtje e detyruar fytyre



Mbrojtje individuale e detyruar kundër rënies nga lartësia



Kalim i detyruar për këmbësorë



Kujdes i përgjithshëm (i shoqëruar me tabela suplementare)

3.4 Tabelë shpëtimi

Karakteristikat thelbësore

- Forma kuadrate ose katërkëndëshe;
- Vizatim i bardhë mbi sfond jeshil (ngjyra jeshile duhet të mbulojë të paktën 50% të sipërfaqes së tabelës).



Drejtime të daljeve të emergjencës



Drejtim dalje që duhen ndjekur, nga sinjalet informuese të tabelave që vijojnë



Ndihma e shpejtë



Barelë



Dush sigurie



Larje syve



Telefon ndihme e
Shpejtë dhe shpëtimi

3.5 Tabelë për mbrojtjen nga zjarri

Karakteristikat thelbësore

- Forma kuadrate ose katërkëndëshe;
- Vizatim i bardhë mbi sfond jeshil (ngjyra jeshile duhet të mbulojë të paktën 50% të sipërfaqes së tabelës).



Lëshues zjarrfikës



Shkallë



Fikës zjarri



Telefon për zjarrfikëset



Drejtimit dalje që duhen ndjekur,
nga sinjalet informuese të tabelave të mësipërme.

ANEKSI III

PËRSHKRIME PËR SINJALISTIKËN E KONTENITORËVE (DEPOZITAVE) DHE TUBACIONEVE

1. Enët e përdorura në vendin e punës që përmbajnë substancë ose preparate të rrezikshme, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, enët e përdorura për magazinim ose tubacionet që shërbejnë për transmetimin e këtyre substancave ose preparateve, duhet të pajisen me etiketë të vizatuar ose me simbole (tabela) me ngjyra në sfond, të përcaktuara në paragrafët e mësipërm.

Ky paragraf nuk aplikohet për enët që përdoren në vendin e punës për një periudhë të shkurtër kohe dhe as kur enët zëvendësohen në vazhdimësi, pra kanë frekuencë përdorimi të shkurtër, si dhe në kushte kur përcaktohen masa alternative të përshtatshme, në rastet e veçanta për informim ose formim, që garantojnë një nivel të njëjtë mbrojtje.

Etiketa që përmendëm më sipër:

- mund të zëvendësohet nga tabela paralajmëruese të përmendura në aneksin II, që ka të njëjtin vizatim ose simbol;
- mund të kompletohet me informacionet e fundit, si: emri, formula e substancave ose e preparateve të rrezikshme, ose me detaje që lidhen me rrezikun që paraqet;

- mund të kompletohet ose zëvendësohet për sa i përket transportit në vendin e punës, me tabelat e përdorura në Komunitetin Europian për transportin e substancave ose preparateve të rrezikshme.

2. Sinjalistika e përmendur më sipër duhet të aplikohet si vijon:

- në anën që shihet ose në anët që shikohen;
- në formë të qëndrueshme, me vetëngjithës ose e lyer.

3. Në etiketat e përmendura në pikën 1 të mësipërme aplikohen nëse është e nevojshme kriteret për karakteristikat themelore të materialeve të parashikuara në pikën 1,4 të aneksit II kushtet e përdorimit dhe në pikën 2 të aneksit II, për sa u takon tabelave të sinjalizimit.

4. Etiketat që përdoren mbi tubacione duhet të aplikohen në mënyrë të dukshme pranë pikave që paraqesin rrezik të madh, si: valvolat, pikat e rakorderive dhe duhet të jenë të përsëritshme disa here.

5. Hapësirat, ambientet ose sektorët e përdorur për depozitimin e substancave ose preparateve të rrezikshme në sasi të mëdha, duhet të shënohen me tabelë paralajmëruese, e zgjedhur pikërisht sipas pikës 3.2 të aneksit II, ose të identifikohet në përputhje me pikën 1 të aneksit III, ose të paktën etiketat e ambalazheve të ndryshme ose enëve të ndryshme të jenë të mjaftueshme për qëllimin e vënë në funksion të pikës 1,5 të aneksit II, me dimensione relative.

Depozita e një sasi të caktuar të substancave ose preparateve të rrezikshme mund të tregohen me një tabelë paralajmëruese “rrezik i përgjithshëm”.

Tabelat ose etiketat e përmendura më sipër duhet të aplikohen sipas rastit, në afërsi të zonave të magazinimit ose mbi portën e hyrjes së lokalit të magazinimit.

ANEKSI IV

PËRSHKRIME PËR SINJALISTIKËN E PËRCAKTUAR PËR TË IDENTIFIKUAR DHE TREGUAR VENDNDODHJEN E PAJISJEVE TË MBROJTJES NGA ZJARRI

1. Kusht paraprak

Ky aneks zbatohet në mënyrë të veçantë për pajisjet e destinuara për mbrojtjen nga zjarri.

2. Pajisjet e mbrojtjes nga zjarri duhet të identifikohen nëpërmjet vendosjes së tabelës me ngjyrë, duke treguar kështu vendndodhjen e tyre, ose nëpërmjet përshtatshmërisë së ngjyrës ku janë vendosur.

3. Ngjyra identifikuese e pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri është e kuqe. Sipërfaqja me të kuqe duhet të jetë e mjaftueshme për të bërë të mundur një identifikim të shpejtë.

4. Tabela e përshkruar në pikën 3.5 të aneksit II duhet të përdoret për të treguar vendosjen e pajisjeve të përmendura.

ANEKSI V

PËRSHKRIME PËR SINJALISTIKËN E PENGESAVE OSE PIKAVE TË RREZIKSHME DHE PËR SINJALISTIKËN E RRUGËVE TË LËVIZJES

1. Sinjalistika e pengesave ose e pikave të rrezikshme

1.1 Për të evidentuar riskun e një goditje kundër pengesave të rënies së objekteve nga njëra anë dhe të personave nga ana tjetër, brenda perimetrit të zonës së ndërtimit në kantier, ku punëmarrësit lëvizin gjatë punës, përdoret ngjyra e verdhë e alternuar me të zezë ose e kuqja e alternuar me të bardhë.

1.2 Dimensionet e sinjalistikës shkojnë në raport me dimensionin e pengesës ose të pikës së rrezikshme që ka për qëllim të sinjalizojë.

1.3 Shiritat e verdhë dhe të zi ose i bardhë me të kuq duhet të kenë një kënd 45° dhe dimension pak a shumë të njëjtë ndërmjet tyre.

1.4 Shembull:



2. Sinjalistika e rrugëve të qarkullimit-lëvizjes

2.1 Kur përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve në mjedise dhe lokale janë të nevojshme, për mbrojtjen e punëmarrësve, rrugët e qarkullimit të mjeteve duhet të jenë qartësisht të sinjalizuara me shirita të vazhdueshëm me ngjyrë lehtësisht të shikueshme. Preferohet ngjyra e bardhë ose e verdhë, në raport me ngjyrën e rrugës.

2.2 Vendosja e shiritave duhet të marrë parasysh distancat e nevojshme të sigurisë ndërmjet mjeteve që do të qarkullojnë pa harruar edhe afërsinë e lëvizjes ndërmjet mjeteve dhe këmbësorëve.

2.3 Rrugët e lëvizjes brenda kantierit, jashtë zonës së ndërtimit duhet të sinjalizohen njëllor në masën e nevojshme, nëse nuk janë parashikuar pengesa ose rrugë të përshtatura.

ANEKSI VI PËRSHKRIME PËR SINJALET E NDRIÇUESHME

1. Karakteristikat thelbësore

1.1 Drita e lëshuar nga një sinjal duhet të prodhojë një kontrast të përshtatshëm ndriçimi në ambient, në raport me konditat e parashikuara të përdorimit, pa provokuar errësimin e syve për shkak të intensitetit të madh të dritës ose shikim të keq për pamjaftueshmëri të intensitetit të dritës.

1.2 Sipërfaqja e ndriçuar që lëshon sinjalin mund të jetë me ngjyrë uniforme dhe sjell një simbol në një sfond të përcaktuar.

1.3 Ngjyra uniforme duhet t'i korrespondojë tabelës treguese të ngjyrave të sinjaleve pika 4 aneksi I.

1.4 Kur një sinjal sjell një simbol, ky i fundit duhet të respektojë për analogji rregullat që aplikohen në përputhje me aneksin II.

2. Rregulla të veçanta përdorimi

2.1 Nëse një dispozitiv lëshon një sinjal të vazhdueshëm dhe një me ndërprerje, sinjali me ndërprerje do të përdoret për të treguar, në raport me atë të vazhduar, një nivel më të lartë rreziku ose një urgjencë më të madhe në ndërhyrjen ose veprimin që kërkohet për zgjidhje.

Gjatësia në kohë e frekuencës së ndriçimit të sinjalit të dritës për secilin nga sinjalet duhet të llogaritet në mënyrë që:

- të garantojë një perceptim të mirë të sinjalit;

- të evitojë konfuzionin si me sinjale të ndryshme ndriçuese ashtu edhe me sinjalin ndriçues të vazhdueshëm.

2.2 Nëse në vendin e sinjalit ndriçues me ndërprerje përdoret edhe sinjal zanor, kodi i sinjalit duhet të jetë identik.

2.3 Një dispozitiv i destinuar për të dhënë një sinjal të ndriçuar në rastin e një rreziku të madh duhet të pajiset me komanda speciale ose me një llambë ndihmëse.

ANEKSI VII

PËRSHKRIME PËR SINJALE AKUSTIKE

1. Karakteristikat thelbësore

1.1 Një sinjal akustik:

a) duhet të ketë një nivel zanor të qartë më të lartë se zhurma në sfond, në mënyrë që të jetë i dëgjueshëm, por gjithsesi pa krijuar shqetësim dhe dhimbje;

b) duhet të jetë lehtësisht i kuptueshëm në raport, veçanërisht me gjatësinë e impulseve, si dhe impulsi i ndarë nga seria e impulseve, duke ndarë qartësisht, nga njëra ana sinjalin akustik dhe nga ana tjetër zhurmën në sfond.

1.2 Në rastin kur një dispozitiv mund të emetojë një sinjal akustik me frekuencë konstante dhe të ndryshueshme, frekuenca e ndryshueshme përdoret për sinjalizim, në raport me frekuencën konstante, për një nivel më të lartë rreziku ose nevojën e një ndërhyrjeje më urgjente ose veprim saktësisht të përshkruar.

2. Kodi i përdorimit

Tingulli i një sinjali të lëshuar duhet të jetë i vazhdueshëm.

ANEKSI VIII

PËRSHKRIME PËR KOMUNIKIMIN ME GOJË

1. Karakteristikat thelbësore

1.1 Komunikimi me gojë vendoset ndërmjet një folësi ose lëshuesi dhe një ose më shumë dëgjuesve, në formën e një teksti të shkurtër, të frazave, të grup fjalësh ose të fjalëve të veçanta.

1.2 Mesazhet gojore duhet të jenë sa më shumë të jetë e mundur të shkurtra, të thjeshta dhe të qarta. Kapaciteti gjuhësor i folësit dhe lehtësia e të dëgjuarit duhet të jenë të mjaftueshme për të garantuar një komunikim gojor të sigurt.

1.3 Komunikimi gojor mund të jetë edhe direkt (përdorimi i një zëri njeriu) ose indirekt (zë njeriu ose sinteza vokale që përhapen nëpërmjet një mjete të përshtatshëm).

2. Rregulla të përshtatshme përdorimi

2.1 Personat e interesuar duhet të njohin mirë gjuhën e përdorur për të qenë në gjendje të kuptojnë korrekt shqiptimin e mesazhit gojor dhe ta përshtatin në funksion të tyre, në një kuptim të përshtatshme në fushën e sigurisë dhe shëndetit.

2.2 Nëse komunikimi gojor është përdorur për zëvendësimin ose plotësimin e sinjaleve me lëvizje (gjeste) duhen përdorur fjalë kyçe, si:

largohu:	për të treguar që është marrë drejtimi i veprimit,
ndal:	për të përfunduar ose ndërprerë një proces,
ndërprit:	për të ndaluar një lëvizje,
ngrije:	për të bërë të mundur ngritjen e një ngarkese,
ule:	për të bërë të mundur uljen e një ngarkese,
përpara;	
mbrapa:	nëse është e nevojshme këto 4 (katër) veprime,
majtas:	koordinohen me lëvizjet (gjeste) korresponduese,
djathtas:	
kujdes:	për të urdhëruar një ndërprerje ose ndalim urgjent,
shpejt:	për të përshpejtuar një lëvizje për qëllim sigurie.

ANEKSI IX
PËRSHKRIME PËR SINJALE ME LËVIZJE (GJESTE)

1. Veçoritë

Një sinjal i përcjellë me veprim duhet të jetë i saktë, i thjeshtë, i bollshëm, i lehtë për t'u ndjekur nga ai që e merr dhe me ndryshim të dallueshëm nga një sinjal tjetër me veprim.

Përdorimi i njëkohshëm i dy krahëve duhet bërë në mënyrë simetrike dhe për një sinjal të vetëm veprimi.

Lëvizjet e përdorura duke respektuar karakteristikat e mësipërme mund të variojnë lehtësisht ose të jenë më të hollësishme në raport me figurat e paraqitura në pikën 3, me kusht që domethënia dhe kuptimi të jetë pak a shumë i njëjtë.

2. Rregulla të veçanta përdorimi

2.2 Personi që jep sinjalin i quajtur "sinjalizues" jep nëpërmjet sinjaleve me veprim, instruksionet e manovrimit, atij që do të marrë sinjalin, i quajtur "operator".

2.3 Sinjalizuesi duhet të tregojë kujdes të veçantë gjatë dhënies së komandave të manovrave, për sigurinë e punëmarrësve që ndodhen në afërsi.

2.4 Nëse përshkrimet e pikës 2.2, nuk janë të mjaftueshme, duhet parashikuar një ose më shumë sinjale ndihmëse.

2.5 Kur operatori nuk mund të ndjekë me garancinë e duhur urdhrat e marra për sigurinë, duhet të ndërpresë procesin e manovrave dhe të kërkojë instruksione të reja.

2.6 Pajisje të sinjalistikës me veprim (gjeste).

Sinjalizuesi duhet të identifikohet lehtë nga operatori.

Sinjalizuesi duhet të veshi ose të mbajë një ose më shumë elementë të përshtatshëm të njohur, si xhakëtë, kaskë, mëngë, krahë, palete.

Elementet e njohjes janë me ngjyrë të ndritshme, mundësisht të vetme, të rezervuar veçanërisht për sinjalizuesin.

3. Veprime të koduara për t'u përdorur

Grupimi i veprimeve të koduara që vijojnë më poshtë, nuk e paragjykon mundësinë e përdorimit të sistemeve të tjerë të veprimeve të koduara në nivel komunitar, në veçanti në disa sektorë në të cilët përdoren të njëjtat manovra.

Domethënia

Përshkrimi

A. Veprime të përgjithshme	
Fillim.	Dy krahët janë të hapur në drejtim horizontal,
Kujdes.	pëllëmbët e duarve janë drejtuar nga përpara.
Marr kontrollin.	
Ndal.	Krahu i djathtë është ngritur drejt lart me pëllëmbën
Ndërprerje.	e dorës së djathtë drejtuar nga përpara.
Mbarimi i manovrimit.	
Mbarim i i operacionit.	Dy duart janë të bashkuara në lartësinë e barkut.



B. Lëvizje vertikale
Ngritje. Krah i djathtë ngrihet drejt lart me pëllëmbën e dorës drejtuar nga përpara, duke përshkruar ngadalë një rreth.



Ule. Krah i djathtë, i drejtuar me pëllëmbën e dorës përmbysur nga poshtë drejt trupit duke përshkruar ngadalë një rreth.

Distanca vertikale. Të dyja duart tregojnë distancë.



C. Lëvizje horizontale
Me ardhë para. Të dy krahët janë palosur, me pëllëmbët e dorës të kthyer nga trupi, parakrahët bëjnë lëvizje të lehta në drejtim të trupit.
Me larguar prapa. Të dy krahët janë palosur, me pëllëmbët e dorës të kthyer nga përpara, parakrahët bëjnë lëvizje të lehta duke u larguar nga trupi.
Nga e djathta. Krah i djathtë i zgjatur më shumë ose më pak, me pëllëmbën e dorës përmbysur, kryen lëvizje të drejtuar djathtas.
Nga e majta. Krah i majtë i zgjatur më shumë ose më pak, me pëllëmbën e dorës përmbysur, kryen lëvizje të drejtuar majtas.
Distanca horizontale. Të dy krahët tregojnë distancë.

D. Rrezik
Rrezik. Të dy krahët të drejtuar lart me pëllëmbët e dorës të kthyer nga përpara.
Ndalim emergjent.
Lëvizje e shpejtë. Veprimet e koduara për të treguar shpejtësinë e lëvizjeve që duhen kryer.
Lëvizje të ngadalta. Veprimet e koduara për të treguar ngadalësimin e lëvizjeve që duhen kryer.

VENDIM
Nr.1032, datë 16.12.2010

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË NDËRTESAVE TË ISH-NDËRMARRJES GJEOLGJIKE, KORÇË, NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS TE MINISTRIA E FINANCIVE, DHE TË ZYRAVE TË AGJENCISË SË SIGURIMEVE SHOQËRORE, KORÇË, NGA MINISTRIA E FINANCIVE TE MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të ndërtesave (zyra e ndërmarrjes, godinë 4-katëshe, që i përket objektit 2, laborator, godina 2-katëshe, që i përket objektit 1, dhe këndi i mbledhjeve, që i përket objektit 3) të ish-Ndërmarrjes Gjeologjike, Korçë, e të truallit të lirë (oborr), nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te Ministria e Financave, për t’u përdorur nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Korçë, sipas planrilevimit dhe formularit të inventarizimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të zyrave të Agjencisë Vendore të Sigurimeve Shoqërore, Korçë, me sipërfaqe 125.3 (njëqind e njëzet e pesë pikë tre) m², të cilat ndodhen në katin e parë të ndërtesës 4-katëshe, në adresën rruga “Sotir Peçi”, Korçë, nga Agjencia Vendore e Sigurimeve Shoqërore, Korçë (sipas vendimit nr.99, datë 21.11.1968 të Komitetit Ekzekutiv të K.P. Rrethit) te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për t’u përdorur nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Vendimi nr.635, datë 29.9.2007 i Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të ndërtesës së Ndërmarrjes Gjeologjike, Korçë, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në Ministrinë e Financave”, shfuqizohet.


4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha


3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror										
Bashkia: Korçë										
Fusha e përdorimit të pronës: zhvillim ekonomik										
	A		B				C			
Nr. rendor	Zona kadastrale dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Emërtesa e pronës vendndodhja/shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
860	8562 Ko-H-11	6/25	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar Dega rajonale Korçë Rr.Korçë-Bilisht	Magazina	Rruga Korçë-Bilisht	210	Zhvillim ekonomik	Ministria e Ekonomisë	Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dega Korçë	
				Hangar	Rruga Korçë-Bilisht	188	Zhvillim ekonomik	Ministria e Ekonomisë	Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dega Korçë	
				Ndërtesë	Rruga Korçë-Bilisht	210	Zhvillim ekonomik	Ministria e Ekonomisë	Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dega Korçë	Ndërtesë 4 katëshe
				Laborator	Rruga Korçë-Bilisht	504	Zhvillim ekonomik	Ministria e Ekonomisë	Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dega Korçë	
				Shesh funksional	Rruga Korçë-Bilisht		Shesh funksional	Ministria e Ekonomisë	Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dega Korçë	(Mbetur në admin. Shtetëror)

PERGATITJE: Emri: <u>Robert Paj</u> Licenca Nr: T2 0428 Dti: 28.03.2003 Data e pergatitjes: 09.06.2010  Vula/Firma	IDENTIFIKIMI I PASURISE ZONA KADASTRALE NR. <u>8562</u> NR. I PASURISE: _____ INDEKSI I HARTES: <u>KO: H-11</u> SHKALLA: 1: <u>500</u> ADRESA E PASURISE: <u>KORRE</u> O/P: <u>KORRE</u> P/K: <u>ISH NO. GJEOLGJIKE</u> P/G: _____ Sh _____ K _____ Ap _____ SHTETI: _____ PRONARI (emri, mbledhri, firma) _____
---	--


SKEMA ORIENTUESE

SHK. 1:500



ISH NDERMARJA GJEOLGJIKE

SHK. 1:500



SIPERfaqe objekti nr. ①	2 KT	312.0 m ²	
- II -	NR. ②	4 KT	110.8 m ²
- II -	NR. ③	1 KT	425.4 m ²
- II -	NR. ④	VEND ROJE	17.6 m ²
- II -	TRALLI (SHESH) FUNKSIONAL	⑤	1579.8 m ²
- II -	GJITHSEJ		2445.6 m ²

KUFIZIMET

VERI - PAS.NR. 6/26 (RRUGE)
 LINDJE - PAS.NR. 6/178, 6/139, 6/140
 JUG - PAS.NR. 6/22, 6/416
 PERENDIM - PAS.NR. 6/24 (RRUGE)

VENDIM
Nr.1079, datë 10.12.2010

PËR KALIMIN E OBJEKTIT “ISH-KOMBINATI I TEKSTILEVE”, BERAT, ME NUMËR PASURIE 19/95, NË ZONËN KADASTRALE 8501, ME SIPËRFAQE 8117 M², NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.226, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 14 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e objektit “Ish-kombinati i tekstileve”, Berat, me numër pasurie 19/95, në zonën kadastrale 8501, në qytetin e Beratit, me sipërfaqe 8117 (tetë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) m², aktualisht në pronësi të “Tekstil, Berat” sh.a., në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor.

2. Prona sipas pikës 1 të këtij vendimi, të shtohet në listën e inventarit të pronave, në administrim të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, miratuar me vendimin nr.226, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1080, datë 22.12.2010

PËR RREGULLAT PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE DHE NË KULLOTA, SI DHE PËR KRIJIMIN E NJËSIVE VULLNETARE TË SHUARJES SË ZJARREVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9 të nenit 20 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për parandalimin dhe zbulimin në kohë të rreziqeve nga zjarret në pyje e kullota, si dhe për shuarjen e tyre, drejtoritë përkatëse të shërbimit pyjor kryejnë këto detyra:

a) Hartojnë planet e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyjet dhe kullotat, në pronësi e në administrim të qeverisjes qendrore, në përputhje me planin e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyjet dhe kullotat, të miratuar nga ministri përgjegjës, dhe me udhëzimet e Drejtorisë së Emergjencave Civile. Në këto plane të jepen në mënyrë të hollësishme masat e veprimet e domosdoshme për parandalimin e rreziqeve nga zjarri, veprimet për

zbulimin e shuarjen e zjarreve dhe për rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara nga zjarri.

b) Organizojnë sistemin e vrojtim-sinjalizimit, i cili funksionon gjatë gjithë vitit në shkallë të ndryshme gatishmërie, në varësi të sezonit të zjarreve.

c) Organizojnë, për shuarjen e zjarreve dhe eliminimin e pasojave të tyre, njësitë vullnetare të shuarjes së zjarreve (NJVSHZ), me 5-15 vullnetarë, të cilët veprojnë gjatë periudhës 1 maj-15 tetor, për pyjet në pronësi të qeverisjes qendrore.

ç) Planifikojnë pajisjen, shpërndarjen dhe përdorimin efektiv të burimeve njerëzore e të materialeve që kanë në dispozicion.

d) Drejtojnë fushata për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për rrezikun e zjarreve dhe mbrojtjen nga zjarri.

dh) Në bashkëpunim me strukturat e Policisë Pyjore dhe të emergjencave civile, organizojnë trajnimin dhe kualifikimin e punonjësve të NJVSHZ-ve, për shuarjen e zjarreve.

2. Kërkesat e pikës 1 të këtij vendimi janë të detyrueshme edhe për njësitë e qeverisjes vendore për pyjet e kullotat komunale në pronësi/përdorim të tyre, pyjet e kullotat private, si dhe për subjektet që ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor e kullësor publik, të cilat përballohen me shpenzimet e tyre.

3. Prefekti miraton planin e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor e kullësor kombëtar, për të gjitha format e pronësisë dhe/ose të përdorimit për qarkun, duke marrë më parë vlerësimin e Policisë Pyjore të rrethit në rajonin përkatës.

4. Për fikjen e zjarreve në pyje e kullota krijohen njësitë vullnetare të shuarjes së zjarreve (NJVSHZ) që funksionojnë në kuadër të shërbimit vullnetar të emergjencave civile.

5. Për parandalimin e zjarreve, inspektorët e Policisë Pyjore kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) Ndalojnë në largësi 200-300 metra ndezjen e zjarreve në pyje e kullota ose jashtë tyre, që rrezikon djegien e pyllit ose të kullotës;

b) Ndalojnë tymosjen e bletëve në pyje e kullota, përveçse kur ky veprim kryhet me mjete që kanë pajisje të posaçme dhe kapak plotësisht të mbyllur;

c) Mbajnë nën kontroll vizitorët, ekskursionistët, grupet sportive, gjatë vizitave të tyre në pyje e kullota;

ç) Ndalojnë përdorimin e tapave të fishekëve të gjahut prej materiali që merr zjarr lehtë (lini, letër, pece etj.);

d) Ndalojnë djegien e kashtës së të korrave të kulturave bujqësore që rrezikojnë përhapjen e zjarreve në pyje dhe kullota, pa marrjen e masave parandaluese;

dh) Kërkojnë ndalimin e qitjeve me predha që shkaktojnë zjarr në zonat me drurë pyjorë të thatë dhe mbeturina pyjore (gjethe, shkarpa, kalbësira etj.) e në kullota;

e) Vendosin në udhëkryqe e vende të dukshme tabela me shënime për mbrojtjen nga zjarri;

ë) Mbajnë në gatishmëri sistemin e lajmërimit dhe mjetet e komunikimit;

f) Raportojnë në vazhdimësi për situatën në linjën e varësisë;

g) Organizojnë prova gatishmërie për të verifikuar skemat e lajmërimit, grumbullimin e njerëzve, gatishmërinë e mjeteve e të sistemeve të ndërlidhjes e të komunikimit.

6. Për shuarjen e zjarreve, Policia Pyjore zbaton detyrimet e përcaktuara në planet e masave, të miratuara sipas pikës 3 të këtij vendimi.

7. Për pyjet komunale dhe për pyjet private, masat parandaluese zbatohen nga njësitë e qeverisjes vendore e pronarët privatë, në përputhje me kërkesat e planit, të miratuara sipas pikës 3 të këtij vendimi. Zbatimi i tyre kontrollohet nga Policia Pyjore.

8. Njësitë e qeverisjes vendore dhe pronarët privatë ngrenë infrastrukturën për mbrojtjen nga zjarri, raportojnë në drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor me kërkesë të saj dhe kontrollohen nga Policia Pyjore për zbatimin e masave parandaluese e të masave për ndërhyrje në raste zjarresh.

9. Shpenzimet për funksionimin dhe përmirësimin e infrastrukturës për shuarjen e zjarreve në fondin pyjor dhe kullësor kombëtar, si dhe për ngritjen e njërive vullnetare të shuarjes së zjarreve (NJVSHZ) përballohen nga personat juridikë dhe/ose fizikë, që i kanë në pronësi/përdorim, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”.

10. Në linjat e tensionit të lartë që kalojnë në pyje dhe kullota, krijohet një trase me gjerësi 20-30 metra, e cila pastrohet vazhdimisht nga drurët dhe mbulesa vegjetative, për të shmangur

zjarret dhe aksidentet e mundshme nga defektet dhe këputjet e linjave. Punimet për hapjen dhe mirëmbajtjen e traseve bëhen në bazë të një projekti teknik, që hartohet dhe miratohet nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, e cila ndjek edhe zbatimin e projektit. Shpenzimet dhe përgjegjësinë për kryerjen e këtij operacioni i ka sektori përkatës i OST-së ose administruesi i linjës.

11. Në anët e rrugëve kombëtare që kalojnë në afërsi të pyjeve, ndërmarrjet e mirëmbajtjes së rrugëve pastrojnë skarpatet e rrugëve nga vegjetacioni i djegshëm me qëllim parandalimin e zjarreve.

12. Djegia e kullotave të infektuara nga barërat e këqija dhe parazitët bëhet me miratimin me shkrim të drejtorisë përkatëse të shërbimit pyjor, sipas nenit 22 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, të ndryshuar.

13. Ndezja e zjarreve në brendësi të zonave të mbrojtura bëhet vetëm në zona të përcaktuara nga administrata e këtyre zonave, pasi të jenë marrë masat e nevojshme për krijimin e kushteve të përshtatshme që parandalojnë përhapjen e zjarrit.

14. Gjatë operacioneve të parandalimit e të shuarjes së zjarreve në pyje dhe kullota, në të cilat ka banesa ose objekte të tjera civile, njësitë e qeverisjes vendore, personat fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë dhe organet e shërbimit pyjor bashkëveprojnë me Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, duke shkëmbyer informacione dhe burime njerëzore e materiale, sipas nevojave respektive dhe mundësive reale.

15. Për shuarjen e zjarreve të mëdha marrin pjesë me forca dhe mjete, sipas kapaciteteve që kanë në dispozicion, të gjitha institucionet shtetërore dhe private, njësitë e reparteve ushtarake etj. Në këto raste, shuarja e zjarrit organizohet e kryhet sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij.

16. Drejtimi organizativ dhe teknik i operacionit për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota bëhet nga inspektori i Policisë Pyjore, përgjegjës për zonën, në rastet kur është e nevojshme vendimmarrja për zgjidhjen e situatave konkrete.

17. Në buxhetin vjetor të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të njëjësive të qeverisjes vendore planifikohet një fond operativ për mbrojtjen e pyjeve dhe të kullotave nga zjarri, për:

a) organizimin dhe funksionimin e përhershëm të sistemit të analizës së të dhënave e për përcaktimin e rasteve të vendimmarrjes për të ardhmen, si dhe për mbajtjen e skuadrave zjarrfikëse pranë organeve të shërbimit pyjor;

b) organizimin e sistemit të vrojtimit/sinjalizimit në të gjithë vendin për fushatat e sensibilizimit e të ndërgjegjësimit të publikut për rrezikun e zjarreve në pyje dhe kullota;

c) kryerjen e punimeve të nevojshme për parandalimin e zjarreve dhe reduktimin e pasojave të tyre (pastrime, rrallime, hapje brezash, kulla vrojtimi etj.);

ç) eliminimin e pasojave të zjarreve (hedhje fare, mbjellje, punime për frenimin e erozionit etj.);

d) shpërblimin e të aksidentuarve në rastet e pjesëmarrjes në shuarjen e zjarreve në pyje;

dh) dhënien e stimuljeve materiale për rastet e kontributeve të veçanta për këtë qëllim;

e) përmirësimin e logjistikës me mjete e pajisje dhe të infrastrukturës mbështetëse në përgjithësi.

18. Mënyra e pagesës dhe e shpenzimeve për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota bëhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, që përcaktojnë mënyrën e lëvrimit të fondeve në rastet e emergjencave civile.

19. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Brendshme dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.915, datë 27.12.2010

**PËR PROCEDURAT E ZGJEDHJES SË ORGANEVE TË DHOMËS SË TREGTISË DHE
INDUSTRIË**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 11, 15, 17 dhe 20 të ligjit nr.9640, datë 9.11.2006 “Për dhomat e tregtisë dhe industrisë”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Zhvillimin e zgjedhjeve për organet e dhomave të tregtisë dhe industrisë në të gjitha qarqet, më poshtë të quajtura “Dhoma”, në bazë të ligjit nr.9640, datë 9.11.2006 “Për dhomat e tregtisë dhe industrisë”, të ndryshuar, më poshtë “Ligji për dhomat”.

2. Në zbatim të ligjit për dhomat dhe për qëllimet e këtij udhëzimi, organet e dhomës, për të cilat do të zhvillohen zgjedhjet janë:

- a) Asambleja e Dhomës;
- b) Kryesia e Dhomës;
- c) Kryetari i Dhomës;
- ç) Komisioni i auditimit.

3. Zgjedhjet e organeve të dhomave zhvillohen me votim të fshehtë sipas grupeve të biznesit të regjistruar në dhomë. Asnjë subjekt tjetër, përveç anëtarëve të dhomës, nuk mund të marrë pjesë në votim.

4. Nga propozimet e bëra nga çdo grup biznesi (5 grupe), me përzgjedhje dhe votim, vendoset përbërja e komisionit të zgjedhjeve, që administron procesin e zgjedhjeve për organet e dhomës, i cili mbështetet nga sekretari i dhomës dhe grupi i punës, i ngritur për këtë proces.

Komisioni zgjedhor përbëhet nga kryetari dhe 4 (katër) anëtarë, si dhe një sekretar komisioni, i zgjedhur nga stafi i dhomës. Sekretari përgjigjet për mbajtjen e procesverbalit dhe dokumentacionit zgjedhor, si dhe ushtron çdo detyrë tjetër që përcaktohet në këtë udhëzim apo që i ngarkohet nga komisioni.

5. Sekretari i dhomës krijon grupin e punës, që është pjesë e stafit të dhomës dhe ndihmon komisionin zgjedhor për procedurat e zgjedhjes së organeve të dhomave të tregtisë dhe industrisë, sipas ligjit për dhomat dhe statutit.

6. Sekretari i dhomës dhe grupi i punës mbikëqyr ligjshmërinë e zbatimit të procedurave nga komisioni i zgjedhjeve.

7. Bazuar në vendimin e asamblesë ekzistuese, brenda 15 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, komisioni i zgjedhjeve cakton datën, orën dhe vendin e zhvillimit të zgjedhjeve për asamblenë e re të dhomës dhe e shpall atë.

8. Sekretari i dhomës verifikon numrin e anëtarësisë së regjistruar në dhomë deri në 15 ditë para datës së zgjedhjeve dhe në bashkëpunim me komisionin e zgjedhjeve përcakton listën përfundimtarëve të anëtarëve, sipas grupeve të biznesit, që kanë të drejtë të marrin pjesë në votim dhe e shpallin atë. Kjo listë e plotë e anëtarësisë depozitohet pranë organit mbikëqyrës, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

9. Lista e plotë e zgjedhësve mbart të gjithë anëtarësimin vjetor të dhomës për vitin 2010, si dhe bizneset që regjistrohen për herë të parë në dhomë deri në 15 ditë para datës së zgjedhjeve për vitin 2011.

KREU II ZGJEDHJA E ASAMBLESË SË DHOMËS

1. Asambleja e Dhomës është organi më i lartë vendimmarrës i dhomës dhe ushtron të gjitha kompetencat që përcakton neni 12 i ligjit për dhomat.

2. Numri i anëtarëve të asamblesë është jo më i vogël se 21 dhe jo më i madh se 101. Në të përfaqësohen të gjitha grupet e biznesit në bazë të përqindjes që zë çdo grup në dhomën përkatëse.

3. Përbërja e asamblesë, shkalla e përfaqësimit dhe kandidatët për anëtarë asambleje, duhet të plotësojnë kriteret që përcakton neni 11 i ligjit për dhomat.

4. Brenda 24 orëve, pas përfundimit të afatit për regjistrim sipas pikës 5 të kreut 1 të këtij udhëzimi, komisioni i zgjedhjeve publikon listat e zgjedhësve për çdo grup biznesi. Një kopje e listës publikohet në ambientet e Dhomës, si dhe në formë elektronike në faqen zyrtare të Dhomës.

5. Jo më vonë se 3 ditë para zgjedhjeve, kandidatët për anëtarë asambleje dorëzojnë formularin e regjistrimit në komision. Formulari duhet të shoqërohet me dhjetë firma të anëtarëve të dhomës, të cilët u përkasin grupit përkatës të biznesit. Një anëtar nuk mund të mbështesë më shumë se një kandidat.

6. Dy ditë para zgjedhjeve, komisioni përcakton listën përfundimtare të kandidatëve për anëtarë asambleje dhe përgatit fletët e votimit, ku shënohen emrat e të gjithë kandidatëve sipas grupeve të biznesit.

7. Votimi hapet në orën 9:00 dhe mbyllet në orën 19:00 në ditën dhe vendin e përcaktuar nga komisioni zgjedhor për votim. Votimi realizohet në një sallë dhe me kuti të veçanta sipas grupeve të biznesit, të regjistruar në dhomë.

8. Anëtarët e regjistruar në listën e votuesve paraqiten për votim në vendin dhe datën e caktuar nga komisioni zgjedhor, dhe duhet të jenë të pajisur me kartën e anëtarësisë dhe një dokument identifikimi. Komisioni kryen verifikimet përkatëse dhe më pas pajis personin me fletën e votimit.

9. Votuesi përzgjedh emrat e kandidatëve për anëtarë asambleje në fletën e votimit, e palos atë dhe e hedh në kutinë e votimit. Votuesi mund të zgjedhë vetëm brenda numrit të caktuar të përfaqësimit në asamble, sipas grupeve të biznesit, përndryshe fleta e votimit konsiderohet e pavlefshme.

10. Me mbylljen e votimit, komisioni fillon procesin e numërimit të votave. Më pas kalohet në renditjen përfundimtare të kandidatëve, duke i klasifikuar ata në bazë të numrit të votave të marra dhe në përputhje me numrin që i takon për çdo grup biznesi.

11. Në rastin kur më shumë se një anëtar ka marrë numër të njëjtë votash dhe kjo është përcaktuese për zgjedhjen në asamble, komisioni organizon hedhjen e shortit në prani të personave të interesuar.

12. Pas përgatitjes së listës së personave që kanë fituar, komisioni harton raportin final dhe emrat e anëtarëve që zgjidhen në asamble. Lista e asamblesë së re, të dalë nga këto zgjedhje i dorëzohet zyrtarisht edhe sekretarit të dhomës.

KREU III ZGJEDHJA E KRYESISË, E KRYETARIT DHE E KOMISIONIT TË AUDITIMIT

1. Jo më vonë se 3 ditë pas përfundimit të procesit për zgjedhjen e asamblesë, sipas procedurave të përshkruara në kreun II të këtij udhëzimi, komisioni i zgjedhjeve thërret mbledhjen për konstituimin e asamblesë së Dhomës dhe kalimin në zgjedhjen e kryesisë, kryetarit të dhomës dhe 2 anëtarëve të komisionit të auditimit.

2. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë 2/3 e anëtarëve të asamblesë.

3. Kandidatët për anëtarë kryesie, kryetar dhe anëtarë të komisionit të auditimit propozohen nga anëtarët e asamblesë. Kandidati për kryetar duhet të mbështetet nga të paktën 15 anëtarë të asamblesë; kandidati për anëtarë kryesie duhet të mbështetet nga të paktën 5 anëtarë; kandidati për anëtarë të komisionit të auditimit duhet të mbështetet nga të paktën 5 anëtarë. Një anëtar asambleje, në secilin prej votimeve të mësipërme, nuk mund të mbështesë më shumë se një kandidat.

4. Procesi i votimit hapet në ditën, vendin dhe orën e përcaktuar nga komisioni i zgjedhjeve dhe secili nga anëtarët e asamblesë ka të drejtë të marrë pjesë në votim.

5. Komisioni pajis anëtarët me tri fletë votimi, nga të cilat një i përket votimit për anëtar kryesie, një për kryetarin e dhomës dhe një për anëtarë të komisionit të auditimit.

6. Fleta e votimit konsiderohet e pavlefshme kur është votuar për shumë kandidatura se sa numri i përcaktuar.

7. Pas përfundimit të votimit, komisioni fillon numërimin e votave për zgjedhjen e kryetarit dhe më pas kalon në numërimin e votave për kryesinë dhe komisionin e auditimit. Kandidati që ka marrë më shumë vota, shpallet fitues.

8. Në rast se në votimin për kryetar, disa kandidatë kanë marrë numër të barabartë votash, votimi përsëritet vetëm për këta kandidatë. Në rast se një rrethanë e tillë ndodh me kandidatët për anëtar kryesie dhe kjo është thelbësore për përcaktimin e fituesit, komisioni organizon hedhjen me short në prani të të interesuarve. E njëjta procedurë si për anëtarët e kryesisë, përdoret edhe për përcaktimin e fituesve të komisionit të auditimit, në rast të numrit të barabartë të votave për disa kandidatë.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Zgjedhjet për organet e Dhomës të mbahen jo më vonë se 1 (një) muaj nga përfundimi i mandatit.

2. Ngarkohen sekretarët e dhomave në të gjitha qarqet për zbatimin e këtij udhëzimi.
Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Ilir Meta**

VENDIM Nr.202, datë 20.12.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO DURRËSI” SUBJEKTIT “RADIO DURRËSI” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radion FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.97, datë 27.8.2010 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Radio Durrësi” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për të mbuluar me sinjal prefekturën Durrës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen: struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE
Endira Bushati**

VENDIM
Nr.203, datë 20.12.2010

PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO EAGLE” SUBJEKTIT “DYNAMICS SOUND” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radion FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.889, datë 6.11.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “Dynamics Sound” sh.p.k. për radion vendore private “Radio Eagle”, sipas licencës nr.051/FML, në qarqet Fier-Vlorë.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.204, datë 20.12.2010

PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR STAR” SUBJEKTIT “STAR TV” SHPK

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabllo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “Star Tv” sh.p.k. për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Star”, në bashkitë Durrës, Kavajë, Lushnjë dhe Elbasan.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.205, datë 20.12.2010

**PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO KRUJA”
SUBJEKTIT PRIVAT FIZIK LULËZIM SPATA**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radion FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr.97, datë 27.8.2010 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat analogjik tokësor subjektin privat fizik Lulëzim Spata, pasi në dokumentacionin e paraqitur mungonte ekstrakti i Qendrës së Regjistrimit Tregtar, deklarata noteriale, garancia bankare, projekti teknik, plani i implementimit të projektit, si dhe CV-të e anëtarëve të bordit drejtues.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.206, datë 20.12.2010

**PËR MOSDHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z.BILBIL HAJDINI PËR TELEVISIONIN
PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR ALFA HAJDINI”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim televiziv privat kabllor, personin fizik Z.Bilbil Hajdini, pasi në dokumentacionin e paraqitur, ekstrakti i Qendrës së Regjistrimit Tregtar, i paraqitur nga subjekti, është marrë në datën 23.2.2010; Të dhënat për kapitalin financiar, sipas deklaratës së ekspertit kontabël të autorizuar janë në pronësi të “Tv kabllor Vjosa” dhe është depozituar në vlerë më të ulët se 10 milionë lekë; Subjekti nuk ka paraqitur organizimin e stafit dhe në projektin teknik nuk ka parashikuar pavarësinë nga rrjeti elektrik. Gjithashtu, subjekti rezulton të jetë në transmetim pa autorizimin, licencimin e KKRT-së.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.207, datë 20.12.2010

**PËR MOSDHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK ZJ.ËNGJËLLUSHE VELIAJ PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR OREXH”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim televiziv privat kabllor, personin fizik, Zj.Ëngjëllushe Veliaj, pasi në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se ekstrakti i QKR-së, i paraqitur nga subjekti, është marrë në datën 17.2.2010 dhe është fotokopje e panoterizuar; Subjekti nuk ka paraqitur organizimin e stafit; Subjekti rezulton të jetë në transmetim pa autorizimin, licencimin e KKRT-së.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.208, datë 20.12.2010

**PËR MOSDHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z.ARBEN ASLLANI PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR 2 ASL”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim televiziv privat kabllor, personin fizik Z.Arben Asllani, pasi në dokumentacionin e paraqitur ekstrakti i Qendrës së Regjistrimit Tregtar është marrë në datën 4.3.2010; Subjekti nuk ka paraqitur organizimin e stafit. Subjekti rezulton të jetë në transmetim pa autorizimin, licencimin e KKRT-së.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.209, datë 20.12.2010

**PËR MOSDHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z.VULLNET NAZËRAJ, PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR ARD&NET”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim televiziv privat kabllor, personin fizik Z.Vullnet Nazëraj, pasi në dokumentacionin e paraqitur ekstrakti i Qendrës së Regjistrat Tregtar i paraqitur nga subjekti është marrë në datën 2.11.2009; Subjekti nuk ka paraqitur organizimin e stafit.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.210, datë 20.12.2010

**PËR MOSDHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z.ARTAN ZHUPANI, PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR FIER-SEMAN”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim televiziv privat kabllor, personin fizik Z.Artan Zhupani, pasi në dokumentacionin e paraqitur subjekti nuk ka paraqitur organizimin e stafit, grilën e strukturës programore, strukturën ditore dhe javore të programeve, të dhënat statistikore mbi programet dhe orët e transmetimit në ditë; Subjekti rezulton të jetë në transmetim pa autorizimin, licencimin e KKRT-së.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.218, datë 20.12.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV KOHA”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat “Tv Koha”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.219, datë 20.12.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV VLORA CHANNEL”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat “Tv Vlora Channel”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet nga data 14.12.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.220, datë 20.12.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO EAGLE”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Eagle”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet nga data 10.12.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.221, datë 20.12.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO EMANUEL”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Emanuel”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim hyn në fuqi në datën 14.1.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.222, datë 20.12.2010

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TV
KABLLOR DEVI E.R.I.”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor kabllor “Tv kabllor Devi E.R.I”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore kabllore.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 12.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.223, datë 20.12.2010

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“MUZIKA JONË”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Muzika Jonë”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet nga data 16.1.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.224, datë 20.12.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV CHANNEL 1”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “Tv Channel 1”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
 2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.237, datë 20.12.2010

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “RADIO TAKE 5” SHPK, PËR
VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO TAKE 5”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë “Radio Take 5” sh.p.k., për vlefshmërinë e licencës së subjektit privat vendor “Radio Take 5”.

BAZA LIGJORE: Neni 7, pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 121, 124 i ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VËREN SE:

Shoqëria “Radio Take 5” sh.p.k. është licencuar për radion private vendore “Take 5”, me vendimin nr.799, datë 17.4.2009 të KKRT-së, duke u autorizuar të funksionojnë si operator radiofonik privat vendor për një periudhë prej 3 vitesh, për të mbuluar me sinjal zonën e rretheve Tiranë-Durrës.

Nga inspektimet e kryera në qytetin e Tiranës, nga specialistët e drejtorisë teknike në KKRT, ka rezultuar se ky operator radiofonik, për periudhën 16-mujore, prill 2009-korrik 2010, nuk kishte filluar transmetimin për të mbuluar me sinjal zonën e tij të licencimit.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, i ndryshuar, neni 34 pika 4/a, sipas të cilit: “Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit kur:..4. Nuk ka filluar transmetimin pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence për një periudhë kohe:

a)180 ditë në transmetimet e radios vendore...”, KKRT-ja me vendimin nr.49, datë 28.7.2010, vendosi paraprakisht heqjen e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Take 5”. Sipas pikës 2 të vendimit, subjekti kishte të drejtë të parashtronte pretendimet e tij brenda një afati 30-ditor. Duke qenë se subjekti nuk paraqiti asnjë pretendim me vendimin nr.132, datë 22.10.2010, KKRT-ja vendosi heqjen përfundimtare të licencës së këtij subjekti.

Në datën 1.12.2010, shoqëria “Take 5” sh.p.k. ka depozituar pranë KKRT-së kërkesë, duke kërkuar revokimin e vendimit nr.132, datë 22.10.2010, me arsyetimin, si më poshtë vijon:

“... arsyeja e mosdaljes në transmetim ka qenë mospajisja me leje përkatëse për frekuencën e linkut nga AKEP-i. Pas vënies në dijeni të vendimit nr.49, datë 28.7.2010 të KKRT-së, subjekti ynë i është drejtuar me shkresën nr.240 prot., datë 3.8.2010, AKEP, për dijeni KKRT-së, për t’u pajisur me këtë leje. Pavarësisht se kjo shkresë, nuk ka qenë një përgjigje apo pretendim posaçërisht për vendimin nr.49, datë 28.7.2010 të KKRT-së, nga ana jonë është konsideruar si e tillë, duke pasur si qëllim bërjen me dijeni institucionit tuaj të arsyes së mosdaljes në transmetim nga ana jonë.”

Bashkëlidhur kërkesës, subjekti ka bashkëlidhur autorizimin individual nr.3393, datë 23.11.2010, me të cilën është akorduar “Leja për përdorimin e frekuencave”, për shoqërinë “Take 5” sh.p.k., për radion “Take 5”.

Subjekti, gjithashtu, thekson se nëpërmjet kësaj lejeje, janë caktuar frekuencat e linkut, të cilat bëjnë të mundur që radio “Take 5” të fillojë normalisht transmetimin.

KKRT-ja konstaton se mosdalja e radios vendore “Take 5” në transmetim është bërë për shkak të pritjes nga ana e tij, për t’u pajisur me lejen individuale për përdorimin e frekuencave, kusht i domosdoshëm për fillimin e transmetimit. Siç rezulton nga dokumentet shoqëruese të kërkesës së depozituar, subjekti në datën 23.11.2010 ka marrë autorizimin individual nr.3393 nga AKEP-i, duke i hapur rrugën transmetimit normal të programeve radiofonike.

Në mbështetje të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, germës “g” të nenit 7, një nga kompetencat e AKEP-it, është:

“Lëshon autorizime individuale për përdorimin e frekuencave”, ndërsa neni 65 i ligjit përcakton se: “1. Personat fizikë apo juridikë mund të përdorin frekuencë vetëm pasi të jenë pajisur, paraprakisht me autorizim nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të këtij ligji...”.

KKRT-ja konstaton se megjithëse spektri i frekuencave për brezat e frekuencave, të caktuara për përdorim për transmetimet radiodifuzive (radio dhe televizive) administrohet nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT), sipas nenit 65 të cituar më lart, subjektet radiotevizive të licencuara nga KKRT-ja, duhet të pajisen me autorizim individual nga AKEP-i, për përdorimin e frekuencave.

Sa më sipër, KKRT-ja e gjen kërkesën e subjektit “Radio Take 5” sh.p.k. të mbështetur në ligj, si rrjedhojë ka vendosur pranimin e saj.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 121, 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të revokojë vendimin nr.132, datë 22.10.2010 të KKRT-së “Për heqjen e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Take 5”.

2. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.

Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 18.1.2011

Doli nga shtypi më 20.1.2011

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADEL PRINT

Tiranë, 2011

Çmimi 36 lekë